



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL

Tiranë, datë 11.03.2020

NJOFTIM PËR SHTYP

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural bën më dije opinionin publik lidhur me thirrjen për aplikime për masat mbështetëse nga “Fondi i Programit për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural, për vitin 2020, bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 100, datë 5.02. 2020, "Për përcaktimin e kriterëve bazë, të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga Fondi i Programit për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural, për vitin 2020", dhe Udhëzimit të përbashkët të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Nr. 3, datë 24.02.2020, "Për kriteret, procedurat dhe mënyrën e administrimit të Fondit të Programit për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural”.

Bazuar në mbledhjen e jashtëzakonshme të Këshillit të Ministrave lidhur me vendimet e marra pas shfaqjes së rasteve të para të COVID -19, sipas protokollit të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, dhe respektimin e masave nga institucionet, për: “Mbylljen e aktiviteteve publike apo jopublike, institucione arsimore, grumbullimet masive në ambiente të hapura apo të mbyllura, konferencat, koncertet, tubimet, dëgjesa publike deri më 3 prill”, AZHBR, në rolin e saj si agjenci zbatuese, njofton pezullimin e aktiviteteve informuese si dhe thirrjen për aplikime për masat mbështetëse nga “Fondi i Programit për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural, për vitin 2020.

AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL